VENDIM
Nr. 606, datë 20.10.2021

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË DREJTËSISË

(ndryshuar me VKM nr. 28, datë 17.1.2024)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.
2. Ministria e Drejtësisë është organi përgjegjës për zbatimin e politikës së drejtësisë, në kërkim të respektimit të Kushtetutës, të ligjeve, realizimit dhe mbrojtjes së dinjitetit, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe kontribuon në parandalimin e shkeljeve të ligjit, në përputhje dhe në funksion të kërkesave të zhvillimit demokratik e të integrimit evropian të Republikës së Shqipërisë.
3. Fushat e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe kompetencat për realizimin e tyre parashikohen në nenet 5 dhe 6, të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar.
4. Ministria e Drejtësisë, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, ushtron çdo përgjegjësi tjetër shtetërore që i ngarkohet me ligj ose akte të Këshillit të Ministrave.
5. Vendimi nr.506, datë 13.9.2017, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë", shfuqizohet.
6. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama